



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.1546/2016

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Hajriz Hoti, e me procesmbajtës Nazmije Beka, në konfliktin administrativ të paditësve, V. H., B. S., A. B., B. C., R. D., V. N., A. Xh., S. K., H. A., F. O., S. T., M. K. dhe H. D., të cilët me autorizim e përfaqëson G. A. avokat në Prishtinë, kundër të paditurit, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson Safet Thaqi, për shkak të anulimit të vendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të autorizuarve të palëve, me dt.28.03.2017, merr këtë,

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar, kërkesëpadia e paditësve, V. H., B. S., A. B., B. C., R. D., V. N., A. Xh., S. K., H. A., F. O., S. T., M. K. dhe H. D.. Anullohet vendimi paditurit, Universiteti i Prishtinës, "Hasan Prishtina" në Prishtinë, me nr.2/988, i datës;26.11.2013, si dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek i padituri.

II. Udhëzohen paditësit që kërkesën për kompenzimin e dëmit ta realizoi në procedurë kontestimore në Departamentin e Përgjithshëm të kësaj Gjykate.

III. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësve, av.G. A. në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë padisë deklarimeve të thëna në seancën e dt.28.04.2015, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovon në tërësi si të bazuar. Gjykatës i ka propozuar që padia dhe kërkesëpadia e paditësve të aprovohet në tërësi sikurse është vendosur në aktykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm. Të anulohet vendimi Senatit të Univeritetit të Prishtinës me nr.2/988, i dt.26.11.2013, siq është vendosur në pikën tre të këtij aktgjykimi. Njëkohësisht mbetemi pranë parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë të dt.25.02.2015, në të gjitha pikat e saj përveq kandidatëve të cilëve u është refuzuar kërkesëpadia sipas pikës I të aktykimit të cituar më lartë pasi që të njëjtit kanë bërë zgjedhje alternative rreth studimeve.

I autorizuari i të paditurit S. Th., në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë thënieve në përgjigjen në padi, deklarimeve të thëna në seancën e dt.28.04.2015, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzon në tërësi si të pabazuar. Duke u bazuar në atë se te neni 13. par. 2.3, të Ligjit për Arsimin e lartë dhe neni 12. par 1.3 dhe statutit të Universitetit të Prishtinës, i cili përcakton se Senati është ai i cili merr vendimin përfundimtar për kriteret që kanë të bëjnë me kriteret e UP-së duke u bazuar në autonomin e Universitetit të Prishtinës. Gjithashtu ka theksuar edhe një herë se propozimet e njësive akademike nuk janë ato që vendosin për listat përfundimtare por me statusin e Universitetit të Prishtinës Senati është ai i cili e jep fjalën përfundimtare për studime të doktoratës dhe si organ vendimarrës ka sqaruar edhe me vendimin e theksuar më lartë kriteret e përcaktuara për studimet e doktoratës. Prandaj duke pasur parasysh se kandidatët që kanë pasur vlerësime të larta duke u bazuar edhe në notat e tyre janë pranuar, ku të njëjtit pas kësaj periudhe kanë arritur edhe me përfundimin e tezës së doktoratës. Andaj një vendim dhe një konkurs i tillë është i pamundur që të kthehet në pikën zero, sepse nuk ka programe të akredituar të vendosura nga MASHT. Andaj i propozoj gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.28.03.2017, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi i të paditurit i dt.26.11.2013, njoftimi i të paditurit i dt.21.01.2014, ranglista e kandidatëve si dhe punimet shkencore të kandidatëve që kanë aplikuar për doktorate i lëshuar nga UP me dt.18.07.2012, ankesa e paditësit S. Sh. drejtuar të paditurit e dt.27.11.2013, parashtrësia e dr.Bujar Dugollit drejtuar rektorit të UP-së e dt.25.10.2013 së bashku me ranglistën përfundimtare të kandidatëve, parashtrësia e fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike drejtuar UP-së me dt.27.11.2013, së bashku me listen e kandidatëve, konkursi i shpallur nga UP i Prishtinës me dt.25.09.2013, ankesa e paditësit B. S. drejtuar të paditurës të dt.29.11.2013, ankesa e paditësit B. S. drejtuar MASH-tit dt.06.01.2014, ankesa e V. H.t drejtuar Inspeksionit të Arsimit në MASH-tit e dt.30.12.2013, ankesa e R. D. drejtuar të paditurës dt.02.12.2013 dhe dt.27.12.2013, ankesa e V. N. drejtuar të paditurit të dt.02.12.2013 dhe dt.27.12.2013, ankesa e paditësve e kandidatëve për doktorate të Fakultetit Filozofik dt.02.12.2013, raporti i komisionit për ankesa dhe parashtrësia drejtuar UP-së me dt.26.12.2013, rekomandimi i lëshuar nga MASH-ti me dt.18.07.2014, ankesa e UP-së kundër rekomandimit të MASH-tit drejtuar sekretarit të përgjithshëm të MASH-tit dt.08.12.2014, parashtrësia e paditësve mbi precizimin e kërkespadiës së bashku me provat e bashkangjitura të dt.25.02.2015, aktgjykimi kësaj gjykate C.nr.442/2014, i dt.28.04.2015, aktvendimi AC.nr.2343/2015 i dt.19.12.2015, si dhe aktvendimi i gjykatës së Apelit CN.nr.13/2016 i dt. 20.09.2016.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Me vendimin e të paditurit Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë nr.02/988, të datës;26.11.2013, i padituri ka përcaktuar kritere shtesë për kandidatët që kanë aplikuar për regjistrim në programet e doktoratës të shpallura për vitin akademik 2013/2014.

Paditësit të pakënaqur me këtë vendim me datë;28.01.2014 ushtrojnë padi në këtë gjykatë duke kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Nga vendimi i kontestuar rrjedhë se ai përmban të meta të tilla për shkak të te cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par.2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar.

Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Vendimi i kundërshtuar është në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Administrative për faktin se i njëjti vendim, nuk ka fare arsyetim dhe se të njëjtit vendim poashtu i mungon edhe këshilla juridike, me të cilën do t'i mundësohet palëve të cilave ju referohet që të ushtrojnë mjete efektive juridike ndaj tij.

Gjithashtu gjykata verën se, vendimi i kontestuar është nxjerrë pas mbylljes së konkursit të datës;25.09.2013, me të cilin i padituri ka përcaktuar kritere shtesë të konkursit.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e të autorizuarit të të paditurit se, “Duke u bazuar në nenin 13.1, par.2.3, të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe neni 12. par 1.3 dhe Statutit të Universitetit të Prishtinës, se Senati është ai i cili merr vendimin përfundimtar për kriteret që kanë të bëjnë me kriteret shtesë për praninë e aplikantëve në Universitetin e Prishtinës duke u bazuar në autonominë e

Universitetit të Prishtinës. Të njëjtin pretendim gjykata e vlerësoi si të pabazuar nga fakti se, këto dispozita ligjore përcaktojnë autorizimet e të paditurit, përkatësisht autonomi e tij që t'i zgjedhë autoritetet menagjuese, zgjedhjen e mesimdhënësve dhe personelit tjetër, por nuk i jep autorizime Senatit të të paditurit që pas mbylljes së konkursit të caktoj kriteret shtesë për pranimin e kandidatëve. Ngase sipas nenit 122 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, të cilit iu ka referuar i padituri, kur ka marrë vendimin e kontestuar me padi, i njëjti nen përcakton se, "1.Pranimi i studentëve në studimet e doktoratës bëhet nëpërmes konkursit publik të cilin e shpallë Universiteti. 2. Të drejtë konkurrimi për regjistrim në studimet e doktoratës kanë: 2.1.Të diplomuarit me titullin akademik magjistër i shkencës përkatëse. 2.2.Të diplomuarit me titullin akademik master i shkencës dhe master i arteve. 2.3.Te diplomuarit ne studimet themelore (5-6 vjecare) te Mjekesise. Kushtet për pranim dhe kriteret për vlerësimin e kandidatëve në studimet e doktoratës i cakton Senati i Universitetit të Prishtinës në pajtim me këtë Statut dhe Rregulloren për studimet e doktoratës. Mirëpo neni 122, të cilit i referohet i padituri nuk i jep të paditurit autorizime ligjore që pas mbylljes së konkursit të caktoj kriteret shtesë për kandidatët dhe mbi këto arsye gjykata vlerëson se, vendimi i kontestuar me padi nga paditësit është i kundërligjshëm.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i paditur, nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, nuk ka zbatuar drejtë Ligjin për Procedurën Administrative dhe nuk ka zbatuar drejtë ligjin material, përkatësisht Statutin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në Prishtinë, kur ka marrë vendimin e kontestuar me padi.

Gjykata si rregull, konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi, nuk mund të kuptohet se, si është vërtetuar gjendja faktike nga i padituri.

Në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Lidhur me kërkesën e paditësve për kompenzimin e dëmit, gjykata ka vendosur duke u bazuar në nenin 46.5 të Ligjit për Konfliktet Administrative, duke e udhëzuar palët paditëse që kërkesën për kompenzimin e dëmit ta realizoj në procedurë Kontestimore, në Departamentin e Përgjithshëm të kësaj Gjykate.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lart, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr.1546/16, dt.28.03.2017

Procesmbajtëse
Nazmije Beka

G j y q t a r
Hajriz Hoti

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.